



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 63
Prishtinë, më 1 qershor 2012

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 1 QERSHOR 2012**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 79 deputetë.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

- **Debat parlamentar lidhur me Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve**

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të vetme të rendit të ditës, i njoftoi deputetët se deputetja e Parlamentit Evropian, Ulrike Lunaçek, ka shprehur dëshirën që, përpos adresimit me një shkresë, t'u drejtohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës edhe nëpërmjet një audio-video incizimi.

Deputetët e Kuvendit e përcollën me interesim fjalën e eurodeputetes Ulrike Lunaçek.

Në vazhdim, kryetari e ftoi kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Suzan Novoberdaliu fillimisht tha se problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen fëmijët në Kosovë janë të shumta. Në vazhdim, ajo theksoi se shoqëria te ne është e re dhe më e varfra në rajon, e këtë konstatim ajo e ilustroi me të dhëna të shumta statistikore.

Ajo më pas tha se sot kemi jo pak raste të abuzimit me fëmijë, ndërsa ne si shoqëri duhet t'u ofrojmë mundësi shumë më të mira.

Më tutje, deputetja Suzan Novoberdaliu u fokusua në një raport të UNICEF-it lidhur me këtë çështje në Kosovë, ndërkaq mesazhet që dalin nga ky raport i përcolli në Kuvend.

Në fund, ajo i paraqiti para Kuvendit rekomandimet me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve. Këto rekomandime mund të harmonizohen ndërmjet grupeve parlamentare, varësisht nga rrjedha e debatit të sotëm.

Flora Brovina, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fillimisht e vlerësoi punën e institucioneve shtetërore në lidhje me përmirësimin e rolit dhe pozitës së fëmijëve në shoqërinë tonë. Këtë e ilustroi me planin dhe strategjinë e Qeverisë 2009-2013.

Në vazhdim, ajo tha se edhe sipas raportit të UNICEF-it, fatkeqësisht Kosova mbetet në fund të këtyre zhvillimeve.

Më pas, ajo u fokusua në fushën e legjislacionit për këtë çështje, me ç'rast, ndër tjera, e përmendi nxjerrjen e Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

Rita Hajzeraj-Beqaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se është për keqardhje që për çështjen e pozitës së fëmijëve në Kosovë flitet vetëm me rastin e 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve. Ajo në vazhdim tha se fëmijët janë pjesa më e ndjeshme dhe e veçantë e një shoqërie dhe është obligim i shoqërisë që atyre t'u ofrojë mundësi sa më të mira për edukim dhe arsimim. Më pas, ajo u fokusua në vështirësitë, me të cilat ballafaqohet kjo kategori në Kosovë, duke e vënë theksin në faktin se shumë fëmijë te ne, për shkak të kushteve ekzistenciale, janë të detyruar të punojnë.

Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj e theksoi edhe faktin se fëmijët në Kosovë janë të detyruar të bartin në shkollë çanta mjaft të rënda, me mbi 10 kg në shpinën e tyre, duke i kritikuar kështu institucionet përgjegjëse arsimore për një gjë të tillë.

Albana Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", fillimisht i kritikoi institucionet shtetërore për joseriozitetin, siç tha ajo, për t'i ndihmuar fëmijët.

Në vazhdim, ajo u fokusua në faktin se fëmijët janë dukshëm të rrezikuar nga varfëria, sidomos ata fëmijë të cilët i kanë prindërit e papunë dhe ata që trajtohen si kategori sociale. Këtë konstatim ajo e ilustroi me faktin se vdekshmëria e fëmijëve në Kosovë nën moshën 5-vjeçare është më e larta në Evropë. Në fund, ajo foli edhe për fëmijët e mbetur jetimë si pasojë e luftës së fundit në Kosovë dhe për pozitën e tyre.

Kymete Bajraktari, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fillimisht tha se gjendja e të drejtave të njeriut në Kosovë e reflekton edhe në gjendjen e të drejtave të fëmijëve te ne.

Në vazhdim, ajo u fokusua në pozitën e vështirë të fëmijëve te ne, duke e ilustruar me faktin se shumë fëmijë janë të detyruar të punojnë për shkaqe ekzistenciale, pastaj e përmendi edhe dukurinë e braktisjes së shkollimit nga fëmijët, si dhe dukurinë e përhapjes së substancave

narkotike në shkolla, si shumë shqetësuese. Institucionet e vendit duhet të ndërmarrin masa të nevojshme, në mënyrë që kjo gjendje të përmirësohet, tha ajo.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se çështja e pozitës së fëmijëve në shoqëri nuk duhet të kuptohet si problem vetëm i Qeverisë, por i të gjithë neve. Në vazhdim ajo e vlerësoi potencialin e madh që ka Kosova për këtë kategori dhe e shtroi nevojën që shoqëria jonë t'u ofrojë kushte më të mira, veçanërisht një arsim sa më cilësor.

Biserka Kostiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, tha se të drejtat e fëmijëve shkelen në forma dhe mënyra të ndryshme. Ata përdoren për qëllime të ndryshme, ndërsa të dhëna të sakta për pozitën reale të kësaj kategorie në Kosovë nuk ka.

Në vazhdim, ajo tha se fëmijët e komunitetit rom nuk janë të regjistruar ende në regjistrat e gjendjes civile në Kosovë. Është detyrë e të gjithë neve përparimi i pozitës së fëmijëve në Kosovë.

Enis Kervan, në emër të Grupit Parlamentar "6+", u fokusua në përmirësimin e pozitës së kësaj kategorie te ne. Duke u bazuar në faktin se fëmijët janë e ardhmja jonë, ai shprehu bindjen se investimi për përmirësimin e pozitës së tyre në shoqëri është investim për të ardhmen tonë.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: **Kymete Bytyçi, ministri Ramë Buja, Rita Hajzeraj-Beqaj, Shaip Muja, Albulena Haxhiu, Albert Kinolli, Goran Marinković, Vjosa Osmani, Blerta Deliu-Kodra, Afrim Hoti, Emilija Rexhepi, Afërdita Berisha-Shaqiri, Xhevahire Izmaqi, Hykmete Bajrami, Ganimete Musliu, Hashim Deshishku, Haki Demolli, Sala Berisha-Shala, Salih Morina, Eqrem Kryeziu dhe Armend Zemaj**, ndërsa deputetët **Latif Gashi** dhe **Fadil Demaku** diskutimet e tyre i dorëzuan me shkrim, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

Suzan Novoberdaliu, në emër të Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në fund të debatit propozoi që rekomandimet të harmonizohen me të gjitha grupet parlamentare dhe të njëjtat të hidhen në votim në mbledhjen plenare të radhës.

Kryetari në vazhdim kërkoi nga deputetët që nëpërmjet një votimi formal të deklarohen lidhur me propozimin e lartpërmendur.

Kuvendi e miratoi propozimin për harmonizimin e rekomandimeve me të gjitha grupet parlamentare lidhur me Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve dhe ato rekomandime të procedohen për votim në mbledhjen plenare të radhës.

Kryetari i konstatoi të mbyllura punimet e mbledhjes së sotme, në orën 12:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI